

STATUSI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

INNOVAIR SHPK

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

EMERTIMI

Sot me date 07 Janar 2023 në bazë të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKB” të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” me vullnetin e lirë te ortakeve Z. Hysmet Ademi, Kole Puka dhe Ndue Hardadhija themelojne shoqërinë *INNOVAIR SHPK*.

Shoqëria e ka selinë në Shkoder, Ndertesha me Nr. Pasurie 9/877/N9, Zone Kadastrale 8592.

Shoqëria *INNOVAIR SHPK* ka të drejtë të celë filial degë e përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë e jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar e ato të vendeve të tjera ku ato do të hapen.

Z. **NDUE HARDADHIJA** është administrator I shoqërisë për afat 5 vjecar, mandat ky qe me vendim asambleje mund te ndryshohet me shumice vote.

NENI 2

Shoqëria *INNOVAIR SHPK* e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozita të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (statutit).

Shoqëria *INNOVAIR SHPK* është person juridik.

NENI 3

Shoqëria *INNOVAIR SHPK* krijohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje mbi 10 vjet.

Shoqëria *INNOVAIR SHPK* mund të zgjatë afatin e veprimtarisë së saj ose mund ta mbyllë aktivitetin e saj para këtij afati, sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut dhe sipas kriterëve që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

NENI 4

Shoqëria *INNOVAIR SHPK* për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e shoqërisë. Pjesëmarrja me këtë shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria *INNOVAIR* SHPK do të ketë si objekt:

Aktivitet ne fushen Elektroshtepiake te medha dhe te vogla si dhe ne fushen e kondicionim aspirimit.

Tregetim import -eksport, aksesoreve te ndryshem elektroshtepiake elektrike.

KREU II

MARRËDHËNIET EKONOMIKE-FINANCIARE

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar I shoqërisë *INNOVAIR* SHPK është **1.500.000** lekë I ndarë ne 3 kuota.

Ky kapital themeltar zotërohet ne 3 kuota te barabarta mes ortaku Z.Hysmet Ademi i shprehur ne para 500.000 leke , ortaku Kol Puka I shprehur ne para 500.000 leke dhe Z. Ndue Hardadhija I shprehur ne para 500.000 leke.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij e janë të transferueshme si ndërmjet nga ortakëve ashtu edhe përkundrejt personave të tretë.

Transferimi I kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakëve dhe me akt noterial.

Cdo vendim per transferim kuotash jashte grupit aksioner pa miratimin e ortakve me akt notarial eshte I pavlefshem.

Në qoftë se njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortakët e tjerë, ose aprovimin e tyre me akt noterial për shitjen e pjesës së tij e një subjekti apo individi tjetër.

Vlerësimi I kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të vecantë ose një nga ekspertët kompetentë I caktuar nga ortakët.

NENI 7



Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet me vendim te asamblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të vecantë qe eshte pergjegjisi e administratorit.

NENI 8

Fitimet neto I realizuar nga aktiviteti I shoqërisë do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre takuese në kapitalin themeltar.

NENI 9

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci I aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet Brenda muajit Janar të vitit që vijon.

Bilanci I aktivitetit financiar eshte pergjegjisi e administratorit por mund të bëhet dhe nga vetë ortakët ose nga ekspertët e tyre. Por në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit financiar duhet ti bëhen të aprovohen nga Asambleja e ortakëve Brenda muajve të mbylljes së vitit financiar.

NENI 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.

Rezervat statuore te jene ne masen 5% te fitimit.

Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga asambleja e ortakëve.

NENI 11

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

NENI 12

Cdo lloj akt marveshje apo kontrate me pale blerese ose bashkpunimi me vlere mbi 500 000 leke behet vetem me miratimin e asamblese.

NENI 13



Administratori është i detyruar që personalisht ose nëpërmjet të perfaqësuesit të tij të paraqes çdo fund muaji situatën e blerje-shitje, gjendjes së magazines dhe gjendjen e të ardhurave të kompanisë pranë asamblese së ortakëve.

NENI 14

Cdo hapje, mbyllje ose transferim aktiviteti bëhet vetëm me miratim të asamblese së ortakëve, në të kundërt administratori merr përsipër çdo lloj dëmi të shkaktuar kompanisë.

NENI 15

Cdo vendim ose veprim i administratorit ose i njërit nga ortakët pa miratimin e asamblese është përgjegjësi individuale dhe si e tillë nuk e prek kompaninë dhe ortakët e saj.

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

NENI 16

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarive ekonomike-tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statusin.

- Të kërkojnë dhe tu japin të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).
- Të bëjnë propozime dhe ti paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.
- Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

NENI 17

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë (për fondin rezervë).
- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.



KREU IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

NENI 18

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vëna në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Miraton Bilancin vjetor të shoqërisë.
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Emëron dhe revokon Ekspertin kontabël të Shoqërisë.
- Kryen modifikime në statusin pas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj me një tip tjetër shoqërie.

NENI 19

Administratori I shoqërisë përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në e më dhe për llogaritë e shoqërisë ne cdo lloj mardhenie me pale te treta.

Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijë nga veprimet e kryera nga administratori. Administrator Z.Ndue Hardadhija ka afat maksimal 5-vjet dhe afati është I detyrueshëm të parashikohet në aktet e shoqërisë.


NENI 20

Administrator është përgjegjësi individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, si dhe shkeljet e kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë. Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë **INNOVAIR SHPK** rregullohen me kontrata individuale, që do të lidhen me secilin prej tyre. Cdo I punsuar prane kompanise behet me miratim asambleje.

KREU V

MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

NENI 21



Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratë në qoftë se ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk zgjatin këtë afat.

Shoqëria mund ti japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

NENI 22

Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit.

Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi I kthehet pronar e vetë saj.

NENI 23

Secili nga ortakët e ka të ndaluar të ushtroje të njëjtin atkivitet qe ushtron shoqëria INNOVAIR shpk, ne nje subjekt tjetër ligjor Brenda kufinjve të Shqipërisë, përvëce ne rastet kur miratohet nga asambleja me akt notarial.


ORTAKET E SHOQËRISË

INNOVAIR SH.P.K

Hysmet Ademi



Kole Puka



Ndue Hardadhija



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR
NOTER MAJLINDA XH. DIBRA



V2023040030000915264

DATE 07/01/2023
NR REP 22

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 07 Janar 2023 (dy mijë e njezet e tre), para meje Notere MAJLINDA XH. DIBRA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Shkoder, Lagjja "Qemal Stafa", Rruga "Daut Borici", pranë Bashkise Shkoder, sipër Vodafonit, kati i II, u paraqiten personalisht:

NËNSHKRUESI:

Kolë Puka, atësia Gaspër, amësia Marije, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Vladimir Jani 03310434; Nd. 34; H. 1; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 14/03/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035852958 dhe nr. personal I10314115D.

NËNSHKRUESI:

Ndue Hardadhija, atësia Dedë, amësia Linë, shtetas Shqiptar, lindur në Sermë, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Sheh Qazim Hoxha 03310381; Nd. 1; H. 8; Ap. 11; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 16/01/1991, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036024522 dhe nr. personal J10116088G, .

NËNSHKRUESI:

Hysmet Ademi, atësia Qemal, amësia Servete, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Bashkimi 03460015; Nd. 21; H. 1; Rrethinat; Bleran; 4015; Shkodër, lindur më 04/04/1994, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BI6233427 dhe nr. personal J40404106H, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statut i Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar INNOVAIR sh.p.k", bashkëlidhur.


Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

MAJLINDA XH. DIBRA

Qemal Stafa



Fq. 1

